

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“HERMES TAXI” SHPK**

Sot më datë 17.05.2024, në Tiranë, u mblohdën dy shtetaset si më poshtë përmenden:

- **Jonida Çakaj**, atësia Astrit, amësia Dallandyshe, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, me adresë Rruga “Pjetër Bogdani”, Nd. 15, H2, Njësia Administrative Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 03.06.1980, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e pajisur me Letërnjoftim ID nr. 035667490 dhe nr. personal I05603052K.
- **Emiliana Rrokaj**, atësia Arqile, amësia Marika, shtetase Shqiptare, lindur në Sarandë dhe banuese në Vlorë, me adresë Rr. “Ismail Qemali”, Nd.152, H.15, Ap 33, 9401 Vlorë, lindur më 28.01.1972, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e pajisur me Letërnjoftim ID nr. 036103373 dhe nr. personal H25128103I.

të cilat, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në bazë të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Q.K.B, hartuan dhe miratuan Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë **“HERMES TAXI” SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, sipas parashikimeve si më poshtë vijon:

**NENI I  
EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“HERMES TAXI” SHPK**, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**NENI 2  
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “Pavarësia”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, Njësia nr. 4, nr. Pasurie 28/408-N4, Z.K. 8603, 9401, Vlorë-Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Asambleja e Përgjithshme mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Objekti i shoqërisë “**HERMES TAXI**” SHPK, do të përfshijë:
- Shërbime në fushën e transportit të udhëtarëve;
  - Shërbime taksi për udhëtarët si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj;
  - Shërbime të transportit urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregulloreve të fushës përkatëse;
  - Tregti dhe dhënie me qira të automjeteve;
  - Auto-Servis i automjeteve, tregti brenda dhe jashtë vendit e pjesëve të këmbimit të të gjitha llojeve si edhe kontroll të përgjithshëm dhe mirëmbajtje për të gjithë mjetet motorike;
  - Kryerjen e të gjithë operacioneve industriale, tregtare, mobiliare dhe imobilare, për përbushjen e qëllimit për të cilin është krijuar shoqëria;
  - Çdo veprimtari tjeter ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizmin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**NENI 5**  
**KAPITALI I SHOQËRISË**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 Lekë (njëqind mijë), i shlyer plotësisht, me para, nga ortakët e Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, të ndara si më poshtë vijon:
- **1 kuotë që përbën 62 % të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 62.000 Lekë, e shlyer nga ortaku Jonida Çakaj;**
  - **1 kuotë që përbën 38% të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 38.000 Lekë, e shlyer nga ortaku Emilianë Rrokaj.**
- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortakët themelues.
- 5.4 Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë tek palët e tre, kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri, pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.
- 5.5 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zoteron secili në kapitalin e Shoqërisë.

**NENI 6**  
**TRANSFERIMI I KAPITALIT**

- 6.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 6.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 6.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**NENI 7**  
**ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontributë në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës se tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjera. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sérish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

**NENI 8**  
**ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**NENI 9**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vndos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim.
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike”. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohej dhe të nënshkruhet procesverbal i përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Thirrja e mbledhjes se Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përparrë datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vtitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përvçese për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, përvime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika 1, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vndos me votat pro të të paktën 51 % të ortakëve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) në bazë të nenit 87 pika 1, të Ligjit nr.



9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

## NENI 10

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria “**HERMES TAXI**” **SHPK** do të administrohet nga Administratori i cili emërohet për një periudhë prej maksimumi 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. Aktualisht, Shoqëria “**HERMES TAXI**” **SHPK** do të administrohet nga: **Z. Arben Rrokaj, atësia Zihni, amësia Sanie, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë Rr. “Ismail Qemali”, Nd.152, H.15, Ap 33, 9401 Vlorë, lindur më 01.02.1971, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me Letërnjoftim ID nr. 037403140 dhe nr. personal H10201188F, i cili do të administrojë shoqërinë “**HERMES TAXI**” **SHPK**, për 5 vjet.**
- Gjithashtu, Administratori Arben Rrokaj autorizohet të paraqesë aplikimin pranë QKB për rregjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“HERMES TAXI” SHPK**.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar prej tij.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve të shoqërisë.
- 10.4 Administratorët nuk kanë të drejtë të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga të tretët.
- 10.5 Administratorët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

## NENI 11

### VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

- 11.2 Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë “**HERMES TAXI**” SHPK në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më datë 31 Dhjetor 2024.

**NENI 12**  
**KONTROLI FINANCIAR**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**NENI 13**  
**BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi securinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finanziar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

**NENI 14**  
**DIVIDENDËT**

- 14.1 Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit finanziar të shoqërisë.

**NENI 15**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, Administratorëve, likuiduesit, do t'i nënshtronhen juridiksonit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**NENI 16**  
**GJUHA**

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

